



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

---

KPK/Nr. 1370/2024

Datë: 27 dhjetor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4, nenit 22 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafit 9 si dhe nenit 24 paragrafit 3 të Rregullores Nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 27 dhjetor 2024, mori këtë:

**VENDIM**

1. Z. Arben Kadriu, prokuror në Prokurorinë Themelore në Gjilan, emërohet Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjilan.
2. Mandati i z. Kadriu fillon nga data 1 janar 2025 për periudhën katër (4) vjeçare.
3. Z. Kadriu, pas përfundimit të mandatit si Kryeprokuror, do të vazhdojë punën në pozitën e prokurorit në prokurorinë ku ka shërbyer si prokuror i Prokurorisë Themelore në Gjilan.
4. Obligohet z. Kadriu që detyrat dhe përgjegjësitë t'i ushtrojë në bazë të legjislacionit në fuqi.
5. Z. Kadriu ka të drejtë në shfrytëzimin e beneficioneve që rrjedhin nga ushtrimi i pozitës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan.
6. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Arben Kadriu, prokuror në PTH Gjilan;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.